



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

UP1 Nr: 08-158
31.05.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-158 datë 17.05.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-158 datë 30.05.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2576/2 datë 31.05.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të mbajtur më 31.05.2024 miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 22-të mbajtur 20.05.2024, me Konkluzion ark.nr.02-2453/2 datë 20.05.2024, e miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-158 datë 17.05.2024 dhe inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-2443/1 datë 16.05.2024, është konstatuar se transmetuesi në aftin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë më 21.05.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-158 datë 21.05.2024, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Megjithatë, më 30.05.2024 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftimi ark.nr.05-2443/2 datë 30.05.2024, se SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, më 30.05.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 3.329.150,00 (tre million e treqind e njëzet e nëntë mijë e njëqin e pesëdhjetë) denarë, ku kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv e pagoi plotësisht.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-158 datë 17.05.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-158 datë 30.05.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2576/2 datë 31.05.2024, Këshilli i Agjencisë në seancën e 25-të mbajtur më 31.05.2024, miratoi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Në bazë nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).